

Pyetje

A lejohet që një njësi ekonomike, e cila nuk plotëson kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “ Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, dhe VKM nr.742, datë 07.11.2007 të mund të zbatojë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK)?

Përgjigje

Në bazë të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar , neni 4, duke qenë se ligji e lejon përdorimin e SNK dhe është stimulues, kushtet e zbatimit të këtyre standardeve nuk janë kriter frenues, shoqëria Juaj mund të përdorë SNK/SNRF-të për ndërtimin e pasqyrave financiare edhe për përdoruesit e jashtëm të informacionit. Së pari, vetë shoqëria i përdor këto standarde për ndërtimin e pasqyrave për raportim tek ortakët dhe të mos ketë kosto shtesë për rindërtimin e tyre me standardet e tjera. Së dyti, vetë standardet kombëtare të kontabilitetit janë hartuar në frymën e standardeve ndërkombëtare.

Pyetje

A mundet që njësi ekonomike të ketë vit ushtrimor të ndryshëm nga ai i caktuar në ligj?

Përgjigje

Për aprovimin e vitit ushtrimor dhe fiskal, sqarojmë se në nenin 14 të Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “ Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, përcaktohet qartë që një aprovim i tillë bëhet vetëm nga KM me propozim të KKK, për veprimtari të veçanta.

Pyetje

A mundet që shoqëria, e cila zhvillon aktivitetin në Shqipëri, mëma e së cilës është e regjistruar në bursë zyrtare të letrave me vlerë jashtë vendit, të mund të përdorë SNK?

Përgjigja

Në bazë të Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “ Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar, neni 4, pika 3/a e tij, shoqëritë tregtare të kuotuar në tregjet e kapitalit brenda ose jashtë vendit dhe filiale të shoqërive të huaja, mëmat e tyre do t'i ndërtojnë pasqyrat financiare në bazë të SNK. Në rast se mëma zbaton SNK, të njëjtën gjë duhet të bëjnë edhe filialet, pavarësisht se ku operon mëma, brenda ose jashtë Shqipërisë.

Pyetje

Referuar Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “ Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 4, paragrafi 3/a përcaktohet se:

“Standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare dhe të përkthyer në shqip,nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze, shpallen nga Ministri i Financave dhe zbatohen detyrimisht:

a) nga shoqëritë e listuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë dhe filialet e tyre, subjekt i konsolidimit të llogarive;”

Ky paragraf nuk përcakton qartë nëse shoqëritë e mësipërme janë:

- a. Shoqëritë shqiptare të listuara në një bursë zyrtare (shqiptare apo të huaj) dhe që kanë degë dhe filiale në Shqipëri dhe jashtë saj, të cilat janë subjekt i konsolidimit të llogarive; apo
- b. Degët dhe filialet e regjistruara në Shqipëri të shoqërive të huaja kur shoqëritë e huaja (pra shoqëritë mëmë) janë të listuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë (shqiptare apo të huaj) dhe dega apo filiali është subjekt i konsolidimit të llogarive.

Përgjigje

Në ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” neni 4, pika 3/a, zbatimi i SNRF–ve është i detyruar si për shoqëritë e listuara në bursë ashtu edhe për filialet e tyre subjekt i konsolidimit të llogarive. Referuar kësaj pike zbatimi i SNRF-ve është i detyrueshëm nga të gjitha njësitë ekonomike që plotësojnë kriteret e të dy grupeve (a dhe b).

Pyetje

Cilat standarde duhet të zbatojnë degët dhe filialet e regjistruara në Shqipëri të shoqërive të huaja, kur vetë shoqëria mëmë është e listuar në një bursë zyrtare letrash me vlerë (shqiptare apo të huaj), por nuk përgatit pasqyrat financiare sipas SNRF por sipas standardeve të tjera?

Përgjigje

Referuar ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” neni 4, pika 3/b, përcaktohet qartë që kur shoqëria mëmë është e listuar në bursë zyrtare të letrave me vlerë, filialet e saj duhet të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, pavarësisht faktit nëse shoqëria mëmë zbaton ose jo SNRF-të.

Pyetje

A përfshihen në kostot e inventarit shpenzimet e komisionit për agjentët e shitjes?

Përgjigje

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, si një organizëm profesional, publik dhe i pavarur, ndër të tjera, në bazë të Ligjit 9228, datë 29.04.2004, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 19, pika ç, ka për detyrë të interpretojë dhe të përgjithësojë problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël.

Për rastin në fjalë, Standardi Kontabël 4 “Inventarët”, paragrafi 18, përcakton shumë qartë që *shpenzimet e shitjes nuk përfshihen në koston e inventarëve*, pra shpenzimet e komisionit për agjentët e shitjes nuk bëjnë pjesë në koston e inventarëve.

Pyetje

Si duhet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare tatimet e shtyra dhe si eliminohen përplasjet me legjislacionin tatimor?

Përgjigje

Nuk është kompetencë e Këshilit Kombëtar të zgjidhë problemet që hasin njësitë ekonomike në zbatimin e legjislacionit tatimor, ndërsa përsa i përket kontabilitetit të tatimeve të shtyra, njësitë ekonomike duhet të bazohen në standardin kombëtar të kontabilitetit nr.11 “Tatimi mbi Fitimin”.

Pyetje

Cilët janë kriteret që duhet të plotësohen nga një element për t’u klasifikuar si aktiv afatgjatë?

Përgjigje

Referuar SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale”, që një aktiv të klasifikohet si aktiv afatgjatë duhet të përmbushë përkufizimet dhe kriteret e mëposhtme:

Aktivët afatgjata materiale (ose AAM) janë aktive materiale që përdoren nga njësitë ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për t’ua dhënë me qira palëve të treta; ose përdoren për qëllime administrative, ose mbahen për rritje të çmimit dhe priten të përdoren në më shumë se një periudhë kontabël.

Një Aktiv Afatgjatë Material (AAM) njihet në bilanc vetëm nëse:

- (a) ky aktiv kontrollon nga njësitë ekonomike raportuese;

- (b) është e mundur që, përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivit do të hyjnë në njësinë ekonomike raportuese;
- (c) kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi.

Aktive afatgjata jomateriale (AAJM) janë aktive të identifikueshme jomonetare pa përmbajtje fizike, të mbajtura për qëllim prodhimin e produkteve ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve, për t'ua dhënë me qira të tretëve ose për qëllime administrative.

Një Aktiv Afatgjatë Jomaterial (AAJM) njihet në bilanc vetëm nëse:

- (a) ky aktiv kontrollohet nga njësi ekonomike raportuese;
- (b) është e mundur që, përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivit do të hyjnë në njësinë ekonomike raportuese;
- (c) kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri.
- (d) aktivi është i identifikueshëm, gjë që e dallon atë nga emri i mirë.

Një AAJM është i identifikueshëm nëse ai:

- (e) mund të shkëputet nga njësi, d.m.th mund të shitet, jepet me qira ose shkëmbehet, ose më vete ose në grup, së bashku me një kontratë, aktiv ose pasiv të lidhur me të;
- (f) rezulton nga të drejtat kontraktuale ose të tjera, pavarësisht nga fakti nëse këto të drejta janë të transferueshme, ose të ndashme nga njësi, ose nga të drejtat, ose detyrime të tjera;

Aktivët afatgjata, të mbajtura për shitje, janë elemente të AAM-së ose AAJM-së, që ka shumë mundësi të shiten brenda 12 muajve të ardhshëm.

Pyetje

Si do trajtohen në kontabilitet përdorimi i inventarizimit periodik dhe jo të vazhdueshëm?

Përgjigje

SKK 4 “Inventarët” është standardi kombëtar kontabël që mbulon vlerësimet dhe politikat kontabël në lidhje me inventarët, por duke lënë në zgjedhjen e drejtimit teknikat kontabël të përdorura. Zgjedhja e teknikës së inventarizimit të vazhdueshëm apo të inventarizimit periodik është e drejtë e drejtimit, për sa kohë nuk bie ndesh me SKK 4.

Pyetje

Lutemi interpretimin e kontabilizimit në **të ardhura**, të paradhënieve të arkëtuara nga kontratat e porosisë së klientëve, në ndërtimin e apartamenteve dhe njësive të shitjes, kur këto paradhënie kalojnë vlerën e punimeve të situacionuara?

Përgjigje

Referuar SKK 8 “Të ardhura”, paragrafi 28, *“Të ardhurat nga kryerja e një shërbimi njihen mbi bazën e metodës së fazës së përfunduar. Sipas kësaj metode, të ardhurat dhe fitimi nga shërbimet njihen në mënyrë përpjesëtimore në të njëjtat periudha kur njihen edhe shpenzimet që lidhen me kryerjen e shërbimeve”*.

Referuar SKK 8 “Të ardhura”, paragrafi 39, *“Kur një shitës shërbimesh i dërgon klientit fatura për shuma më të mëdha ose më të vogla se të ardhurat e llogaritura sipas metodës së fazës së përfunduar, atëherë diferenca do të njihet ose si detyrim, ose si e kërkesë e arkëtueshme”*.

Referuar SKK 8 “Të ardhura”, paragrafi 54, *“Tepricat që rezultojnë nga kontratat e papërfunduara të ndërtimit duhet të paraqiten si më poshtë:*

(a)shuma totale e tepricave pozitive të punës në proces duhet të përfshihet në aktivet afatshkurtra në një zë më vete në bilanc. Këto teprica përfaqësojnë shumat e papaguara nga klientët;

(b)shuma totale e tepricave negative të punës në proces duhet të përfshihen në pasivet afatshkurtra brenda grupit të pasiveve të pagueshme nga aktiviteti dhe pasive të tjera të pagueshme. Këto teprica përfaqësojnë të ardhura të shtyra dhe duhet të përshkruhen si shuma që njësia u detyrohet klientëve;

(c)shuma të faturuara klientëve, pagesat e të cilave nuk janë marrë në datën e bilancit. Këto teprica duhet të paraqiten si kërkesa të arkëtueshme nga aktiviteti”.

Pyetje

A duhet që një njësi ekonomike, e cila ka hapur një llogari bankare jashtë Shqipërisë të pasqyrojë veprimet bankare në këtë llogari në kontabilitetin e saj?

Përgjigje

Referuar në Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 3, pika 1, kemi këtë përkufizim: “Mbajtja e kontabilitetit është regjistrimi në ditar dhe në llogari i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomike, që i përkasin një njësie ekonomike”.

Duke mbajtur në konsideratë këtë përkufizim të ligjit si dhe frymën e standardeve të kontabilitetit të pasqyrave financiare (...ato duhet të japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë...) shprehemi se llogaritë bankare të çdo njësie ekonomike, pavarësisht territorit gjeografik të bankës ku ato janë hapur, janë të detyrueshme për t’u regjistruar për të mos cënuar vërtetësinë e pasqyrave financiare të njësisë ekonomike.

Mundësia e hapjes së një numri llogarie në një bankë të huaj si dhe përsa i përket marrëdhënieve me tatimet nuk përfshihet në kompetencat e KKK-së.

Pyetje

Sipas SKK 12 “Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit” për financimet që ortaku bën gjatë periudhës ushtrimore në monedhë të huaj e që në fund të periudhës ushtrimore janë në bilanc si detyrim ndaj ortakut, diferencat e konvertimit do të përfshihen në rezultatin e ushtrimit, në zërin e ushtrimit “Diferenca nga Kurset e Këmbimit”?

Përgjigje

Interpretimi i plotë dhe i saktë përshkruhet në paragrafin 10, pika a, dhe në paragrafin 12, të SKK 12. Sipas të cilëve, respektivisht, detyrimet për financimet e ortakut në rastin konkret, do të konvertohen me kursin e këmbimit në datën e bilancit, dhe diferencat do të njihen si fitim (ose humbje) në rezultatin e periudhës, dhe jo në llogarinë “Diferenca nga Kurset e Këmbimit”, por në llogarinë 669 / 769 Humbje / Fitim nga këmbimet valutore.

Pyetje

Lutemi të na jepni interpretimin tuaj për rastet kur diferencat nga kurset e këmbimit do të njihen në zërin e kapitalit si “Diferenca të porealizuara të këmbimit” dhe jo në rezultatin e ushtrimit.

Përgjigje

Interpretimi i paragrafit 19 të SKK 12 shprehet vetë në këtë paragraf dhe në paragrafin 18. Llogaria “Diferenca të porealizuara nga kurset e këmbimit” njihet diferencat e krijuara nga konvertimi i pasqyrave financiare të filialit për efekt konsolidimi me shoqërinë mëmë, dhe rastet e rivleresimit të aktiveve.

Pyetje

Si do të mbahen marrëdhëniet e brendshme midis degëve dhe qendrës?

Përgjigje

Kur një shoqëri e ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet degëve, të cilat janë të shpërndara nëpër rrethe, marrëdhëniet e degëve me qendrën mbahen përmes llogarive të marrëdhënies të brendshme. Kështu që marrëdhëniet mes tyre për shitje e blerje shërbimesh do të kanalizohen nëpërmjet llogarisë “Marrëdhënie të brendshme” dhe jo nëpërmjet llogarive të shpenzimeve dhe llogarive të të ardhurave.

Pyetje

Për një shoqëri e cila është në proces likuidimi duhet të llogaritet amortizimi i aktiveve afatgjata apo jo?

Përgjigja

Referuar SKK 5, paragrafi 86 *“Amortizimi i aktiveve afatgjata, të klasifikuara si të mbajtura për shitje, ndërpritet në kohën e riklasifikimit të aktivitetit. Nëse vlera e drejtë e aktivitetit (minus koston e përlllogaritur të shitjes) është më e ulët se vlera kontabël e tij, aktivi i klasifikuar si i mbajtur për shitje do të zvogëlohet deri në vlerën e drejtë (minus koston e shitjes). Një aktiv afatgjatë, i klasifikuar si i mbajtur për shitje, nuk amortizohet edhe pse ai vazhdon të përdoret në prodhim nga njësi ekonomike deri në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit (d.m.th. shitjes)”*. Sqarojmë se njësi ekonomike nuk duhet të llogarisë amortizimin e aktiveve afatgjata të mbajtura për shitje. Këto aktive e humbin vlerën e tyre me kalimin e kohës dhe për paraqitjen e drejtë dhe të vërtetë të vlerës së tyre në P.F, njësi ekonomike i referohet përsëri SKK 5, paragrafi 85 *“Aktivet afatgjata, të klasifikuara si të mbajtura për shitje, vlerësohen me vlerën më të ulët midis vlerës së tyre kontabël dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes, dhe paraqiten më vete në bilanc”*.

Pyetje

Një njësi ekonomike që ka aktivitet konçensionar dhe nuk i plotëson kriteret për SNK/SNRF, mund të referohet standardeve ndërkombëtare meqënëse tek ato kombëtare të kontabilitetit nuk gjen referim për këtë trajtim kontabël?

Përgjigje

Meqënëse SKK nuk specifikon një politikë të caktuar kontabël lidhur me konçensionet, për zgjidhjen mund t'i referoheni literaturës ndërkombëtare kontabël.

Pyetje

Autoritetet rregullatore mund të përdorin Standarde Ndërkombëtare, kur njësitë të cilat ato rregullojnë i zbatojnë këto standarde?

Përgjigje

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në mbështetje të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”*, i ndryshuar, neni 19, pika d, në kuadër të disa ndryshimeve ligjore, vendosi të propozojë pranë Ministrisë të Financave përveç të tjerash një amendim të ligjit të mësipërm në nenin 4, pika 3 / b, i cili do të formulohet me këtë përmbajtje: *“Nga bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare të ngjashme me bankat, shoqëritë e sigurimeve dhe të risigurimeve, fondet e letrave me vlerë, të gjitha shoqëritë e licencuara për të kryer veprimtari investimi në letrat me vlerë dhe të gjithë rregullatorët e njësive ekonomike të*

mësipërme, edhe kur këto njësi ekonomike nuk janë të listuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë.”

Me miratimin e këtyre ndryshimeve institucionet rregullatore do të kenë bazën dhe argumentin ligjor për të zbatuar SNK / SNRF në hartimin e pasqyrave financiare.

Pyetje

Në SKK 5, “Aktivet Afatgjata Jomateriale” për AAM-të e paamortizueshme (toka, troje etj) nuk është dhënë mënyra, shuma dhe koha e transferimit të “rezervave (tepricave) të rivlerësimit” në fitimet e pashpërndara, ashtu siç është dhënë për AAM-të e amortizueshme, transferimi i të cilave bëhet për çdo vit në masën e diferencës midis amortizimit para vlerësimit dhe atij pas vlerësimit. Kjo le hapësirë që “rezervat (tepricat) e rivlerësimit” të krijuar nga rivlerësimi i tokave dhe trojeve, të konsiderohen si fitim i pashpërndarë apo rezervë e disponueshme dhe mund të kalohën që në vitin e parë të krijimit në rritje të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Bazuar në Ligjin Nr.9228, datë 29.04.2004 “ Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit është i vetmi organizëm profesional që mund të interpretojë dhe të përgjithësojë problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël.

1. Cili është trajtimi kontabël i “rezervave (tepricat) e rivlerësimit” të krijuara nga AAM-të e paamortizueshme?
2. A është i nevojshëm qartësimi dhe interpretimi i dallimit midis rezervave të krijuara nga fitimet dhe rezervave apo tepricave nga burime të tjera, pjesë e kapitaleve të veta dhe nëse po, cili do të ishte interpretimi, kryesisht kjo e lidhur me rastin konkret që është konstatuar?

Përgjigje

Referuar SKK 1, pg. 73 “Në rastet kur SKK nuk specifikojnë një politikë të caktuar kontabël, por kjo rregullohet nga një standard i SNRF, atëherë këshillohet që të përdoret si bazë politika e përshtatur në standardin e SNRF-së.....”.

Në këtë kontekst, interpretimi i pg. 32, të SKK 5 kërkon t’i bëhet referencë pg. 41, SNK 16 “Toka, Ndërtesa, Makineri dhe Pajisje” në të cilin thuhet: - *“Rivlerësimi në rritje i përfshirë në llogarinë e kapitalit në lidhje me një zë të grupit toka, ndërtesa, makineri e pajisje mund të transferohet direkt tek fitimi i bartur kur aktivi çregjistrohet nga librat e kontabilitetit. Kjo mund të aplikohet për të gjithë tepricën e rivlerësimit në rritje, kur aktivi është amortizuar tërësisht apo është nxjerrë jashtë përdorimit. Megjithatë, një pjese e tepricës mund të transferohet edhe kur aktivi është duke u përdorur nga subjekti. Në një rast të këtillë, vlera e tepricës së transferuar do të jetë diferenca midis amortizimit bazuar në vlerën e rivlerësuar të aktivit dhe amortizimit bazuar në koston origjinale të aktivit. Transfertat nga tepricat e rivlerësuar tek fitimi i mbartur nuk duhet të bëhen nëpërmjet llogarisë së fitim/humbjes”.*

Parimi i pg. 41 të SNK16 është ai i kalimit të tepricës për vlerën e plotë të saj në fitim të mbartur vetëm kur aktivi çregjistrohet dhe ka një mundësi të dytë vetëm për ato aktive që amortizohen, për të cilat mund të bëhet dhe një llogaritje përkatëse. Në rastin konkret, aktivi “Toka, Troje” nuk mund të përfshihet në opsionin e dytë pasi, të cilësuar si aktive me jetë të papërcaktuar, për to nuk përlogaritet amortizim.

Por, përsëri referuar SNK 16, pg. 77, pika f, *“tepricat nga rivlerësimi, duke treguar ndryshimin në këtë periudhë dhe çdo kufizim në lidhje me shpërndarjen e këtyre tepricave tek aksionerët”*, njësitë ekonomike duhet që në shënimet e tyre shpjeguese të japin mjaftueshëm sqarime lidhur me faktin se në fitimin e pashpërndarë nuk janë kaluar tepricat që vijnë nga rivlerësimi i aktiveve toka dhe troje apo ndonjë aktivi tjetër material i paamortizueshëm.